



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT
TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

Nr. 3059 Prot.

Tiranë, më 18 .9.2018

Lënda: Raporti i monitorimit të performancës së produkteve të buxhetit të ILDKPKI, për 8 – mujorin e vitit 2018.

Drejtuar: **Znj. Gelardina PRODANI**
NËPUNËS I PARË AUTORIZUES
MINISTRIA E FINANCAVE

TIRANË

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, në zbatimin e buxhetit të shtetit për 8-mujorin e vitit 2018, është mbështetur në kërkesat institucionale, në zbatim detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i ligjit nr.9049, datë 10.4.2003, “Për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive, të Detyrimeve Financiare të të Zgjedhurve dhe të Disa nëpunësve Publikë”, i ndryshuar, ligjit nr.9367, datë 7.4.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike” i ndryshuar, parandalimit dhe goditjes së korrupsionit në sektorin publik e privat, në përputhje me ligjin nr.60/2016, datë 2.6.2016, “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, si më poshtë vijon;

Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, në mbështetje të Ligjit nr.109/2017, “Për Buxhetin e vitit 2018”, Udhëzimit nr.2, datë 19.1.2018, «Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018» i ndryshuar, i është akorduar një fond buxhetor prej 138 milion e 349.1 mijë lekë, i cili përbëhet nga:

Fondi i Pagave 102 milion e e 500 mijë lekë (zëri 600)

Fondi i Sigurimeve Shoqërore: 15 milion e 700 mijë lekë (zëri 601)

Fondi për Shpenzime Operative: 16 milion e 760 mijë lekë (zëri 602)

Fondi për Investime: 3 milion lekë (zëri 231)

Transferime korrente: 389.1 mijë lekë (zëri 606)

Buxheti është akorduar për programin “Menaxhim, Administrim, Palanifikim” dhe është i mbështetur në Deklaratën e Politikës të hartuar gjatë procesit të PBA 2018-2020.

Referuar buxhetit të vitit 2018, ILDKPKI në mbështetje të burimeve financiare në dispozicion, ka realizuar objektivat e planifikuara, në funksion të rritjes së cilësisë së kontrollit të interesave private dhe parandalimit të konfliktit të interesit.

Në respektim të rekomandimeve të dhëna, fondi i planifikuar buxhetor është vënë në funksion të objektivave për forcimin e mëtejshëm të hetimit administrativ, të deklarimit të kontrollit të pasurive dhe për parandalimin dhe zgjidhjen së konfliktit të interesave të personave të zgjedhur, nëpunësve publikë dhe zyrrarëve të tjerë. ILDKPKI në mbështetje të burimeve financiare në dispozicion, ka realizuar objektivat e parashikuara në funksion rritjes së cilësisë së kontrollit të interesave private dhe parandalimit të konfliktit të interesit, qëllimit dhe objektivave të cilat lidhen me zbatimin e politikave buxhetore, me qëllimin e realizimit të Misionit të ILDKPKI, në përputhje me objektivat prioritare të institucionit.

Nga fondi i përgjithshëm buxhetor, në zbatim të dhëzimit nr.2, datë 19.1.2018, «Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018», për periudhën e raportuar, Inspektorati i Lartë ka realizuar vlerën buxhetore në vlerën 86,781,614.89 lekë ose 90.05 %, të fondit të planifikuar për 8-mujorin e vitit 2018.

Llog Ek	Përshkrimi	Plan-Buxheti vjetor 2018	Plan-Buxheti 8-mujor 2018	Buxheti I realizuar 8-mujor 2018	Realizimi në % si 8-mujor
600	Fond Page	102,500.00	70,300.00	67,089,761.00	95.43%
601	Kontrib.Sig Shoq & Shend	15,700.00	10,700.00	8,982,686.00	83.95%
602	Shpenzime operative	16,760.00	12,040.00	9,147,406.89	75.98%
606	Transferta per financime te tjera	389.10	309.10	309,100.00	100.00%
231	Investime	3,000.00	3,000.00	1,252,661.00	41.76%
Shuma		138,349.10	96,349.10	86,781,614.89	90.07%

Fondi i Pagave dhe Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore, (zeri 600-601), është realizuar në zbatim të strukturës organizative të miratuar. Gjatë 8-mujorit të vitit 2018, numri mesatar i punonjësve është realizuar 70 vetë, nga 70 vetë të miratuar.

Me Vendim të Këshillit të Ministrave nr.209, datë 20.4.2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.60, datë 31.1.2018, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2018 në njësitë e qeverisjes qendrore”, pika III, është miratuar një punonjës me kontratë të përkohshme deri në fund të vitit 2018.

Fondi i përgjithshëm i pagave dhe i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, për këtë periudhë, është realizuar për numrin faktik të punonjësve në vlerën 67,089,761 lekë ose 95.43% e fondit të planifikuar për periudhën respektive dhe për kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në vlerën 8,982,686 lekë ose 83.95% e planifikimit 8-mujor.

Fondi për shpenzime në zerin investime (zeri 231),

Gjithsej fondi i planifikuar i investimeve për vitin 2018, është 3 milion lekë dhe për periudhën respektive 8-mujore, është realizuar prokurimi në vlerën 2,770,000 lekë ose 92.3% e fondit të planifikuar për vitin 2018 dhe likujduar vlera 1,252,661 lekë.

Inspektorati i Lartë, në zbatim të dispozitave ligjore në fuqi dhe të planifikimit në Regjistrin e Parashikimeve të Prokurimeve Publike të vitit 2018, të publikuar, për këtë periudhë të vitit, në këtë zë shpenzimi për fondet e planifikuara të vëna në dispozicion paraqitet si më poshtë:

1. Fondi i investimeve me objekt “*Blerje pajisje kompjuterike dhe elektronike*”, miratuar si produkt nga Ministria e Financave, është prokuruar me procedurën kërkesë për propozim, me fond limit në vlerën 1,500,000 lekë dhe është fituar nga shoqëria private “BNT ELECTRONICS” Shpk, në vlerën 1,186,680 lekë ose 79.1% të fondit të planifikuar.

Likujdimi është kryer në zbatim të detyrimeve të kontratës dypalëshe nr.1233 prot. datë 9.3.2018, në zbatim të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*” i ndryshuar, dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.914 datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar.

2. Fondi i investimeve me objekt “*Blerje Kondicioner Profesional me Precizion të Lartë*”, i miratuar si produkt nga Ministria e Financave, është prokuruar me procedurën kërkesë për propozim, me fond limit në vlerën 1,500,000 lekë dhe është fituar nga shoqëria privat, SYNAPSE ATS” Sh.p.k, në vlerën 1,380,000 (*një milion e treqind e teëdhjetë*) lekë me TVSH., ose 92% të fondit të planifikuar. Likujdimi do të kryhet në zbatim të detyrimeve të kontratës dypalëshe nr.2904 prot. datë 20.7.2018.

3. Fondi i investimeve me objekt “*Blerje frigorifer për zyrë*” është miratuar si produkt nga Ministria e Financave, në vlerën 70,000 lekë, si fond i rialokuar nga kursimet në procesin e prokurimeve dhe është realizuar me procedurën e blerjeve nën vlerën 100,000 lekë në masën 94.2% e fondit të planifikuar.

4. Fondi i investimeve me objekt “*Blerje të tjera pajisje zyre*” është miratuar si produkt nga Ministria e Financave, në vlerën 230,000 lekë, si fond i rialokuar nga kursimet në procesin e prokurimeve. Ky fond është në procesin e prokurimit me procedurën e blerjes me vlerë të vogël.

Fondi për shpenzime në zerin Mallra dhe Shërbime (zeri 602),

Realizimi për grupin e shpenzimeve operative per 8-mujorin e vitit 2018, është gjithsej në vlerën 9,147,406.89 lekë me tvsh ose 75.98% e fondit të planifikuar për këtë periudhë, duke respektuar dispozitat ligjore në fuqi.

1. Fondi i parashikuar për grup artikullin shërbimi me objekt “*Ruajtja dhe Sigurimi i Godinës së ILDKPKI me roje objekti 24 ore*”, në zbatim të Ligjit nr. 9643 date 20.11.2006, “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 33, VKM nr.914 date 29.12.2014 “*Për miratimin e Rregullave të prokurimit Publik*”, i ndryshuar, Kreu IV, neni 36, për nevojat e fillim vitit,

me shërbimin e ruajtjes me roje civile deri në kryerjen dhe përfundimin e procedurave të prokurimit me këtë objekt, ka realizuar.

- Kontratë shtesë në vlerën e 20% të kontratës fillestare, me objekt "*Ruajtja dhe sigurimi i godines te ILDKPKI me roje objekti 24 orë*", në vlerën 427,287 (*katërqind e njëzet e shtatë mijë e dyqind e tetëdhjetë e shtatë*) lekë pa TVSH dhe 512,745 (*pesëqind e dymbëdhjetë mijë e shtatëqind e dyzet e pesë*) lekë me tvsh, me operatorin ekonomik "*International Security Albania*" Shpk, vlerë kjo e realizuar në përputhje me kushtet dhe specifikimet e kontratës.
- Kontratë me objekt "*Shërbimi i ruajtjes me roje civile*" për godinën e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, me procedurën me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, për periudhën, (7.3.2018 – 7.4.2018), sipas specifikimeve teknike, fituar nga firma private "*International Security Albania*" sh.p.k, në vlerën është 242,993.87 (*dyqind e dyzet e dy mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tre mijë, pikë tetëdhjetë e shtatë*) lekë pa tvsh, dhe 291,592.64 (*dyqind e nëntëdhjetë e një mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e dy pikë gjashtëdhjetë e katër*) lekë me tvsh, vlerë kjo e realizuar në përputhje me kushtet dhe specifikimet e kontratës.
- Me përfundimin e procedurës "*Kërkesë me Propozim*" me fond limit - 3,074,651 (*tre milion e shtatëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e një*) lekë pa TVSH, nga buxheti i shtetit, është lidhur Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku te gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat 12 muaj, nga momenti i nënshkrimit të marrëveshjes kuadër, me objekt "*Shërbimi i ruajtjes me roje civile*" për godinën e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, kjo procedurë është fituar nga AK, Eurogjici – Security, në vlerën 2,915,970.40 (*dymilion e nëntëqind e pesëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë, pikë katër*) lekë pa TVSH dhe 3,499,164.48 (*tre milion e katërqind e nëntëdhjetë e nënëte mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e katër pikë dyzet e tetë*) lekë me TVSH, si oferta e suksesshme. Likujdimi kryhet cdo muaj, në mbështetje të kontratës dypalëshe nr.1911 Prot, datë 20.4.2018.

2. Fondi i parashikuar për grup artikullin "*Blerje materiale kancelarie*", me fond limit për 800,000 lekë, është realizuar me procedurën e blerje me vlerë të vogël dhe është fituar nga firma privatme "*Infosoft Office*" sh.p.k në vlerën 750 mijë lekë me tvsh ose 93% e fondit të planifikuar. Likujdimi është kryer konformë specifikimeve teknike të kërkuara.
3. Fondi i parashikuar për grup artikullin "*Blerje Bojra Printerit dhe Fotokopje*" për ILDKPKI, me fond limit për 1.9 milion lekë, është në prokuruar, në zbatim të procedurës "*Kërkesë për Propozim*" në mbështetje dispozitave ligjore në fuqi dhe realizuar në vlerën 1,873,702.8 lekë me tvsh, fituar nga shoqëria private "*Infosoft Office*" shpk, në mbështetje të marrëveshjes dypalëshe.

Gjatë kësaj periudhe janë realizuar në përmbushjen e detyrimeve me shtetin si posta, energji, ujë, telefoni. Gjithashtu gjatë kësaj periudhe janë lidhur kontrata shpenzim i abonimit ne shtyp, siguracione te detyrueshme per automjetet e ILDKPKI, kontrata e shërbimit të mirëmbajtjes së ashensorit, larjes së automjeteve e tj. të cilat institucioni ynë, i likujdon çdo muaj në mbështetje të specifikimeve teknike të sanksionuara në mareveshjet dypalëshe.

Përsa i përket shpenzimeve për blerje mallra të natyrave të ndryshme, institucioni ynë për këtë periudhë, i ka prokuruar dhe realizuar sipas nevojave konkrete, në mbështetje të dispozitave ligjore në fuqi.

Realizimi i shpenzimeve të akorduara për ILDKPKI, për 8-mujorin e vitit 2018, është mbështetur në Regjistrin e Parashikimeve te Prokurimeve Publike të vitit 2018 dhe kerkesave konkrete të institucionit, të kërkesave për përmirësim e mëtejshëm të punës në menaxhimin dhe zbatimin e objektivave të përcaktuara, duke zbatuar me korrektesi të gjitha detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni financiar nëpërmjet një administrimi korrekt dhe kontrolli të vazhdueshëm.

Realizimi i të ardhurave nga veprimtaria e ILDKPKI.

Të ardhurat nga veprimtaria e ILDKPKI, vijnë kryesisht nga;

1) Arkëtimi i gjobave të vendosura për rastet e shkeljes së detyrimeve ligjore, gjatë zbatimit të ligjit nr.9049, datë 10.4.2003, «Për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive, të Detyrimeve Financiare të të Zgjedhurve dhe të Disa Nëpunësve Publikë» i ndryshuar, parandalimit dhe goditjes së korrupsionit në sektorin publik e privat, në përputhje me ligjin nr.60/2016, datë 2.6.2016 «Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve» nga subjekte në sektorin publik dhe privat.

Për 8-mujorin e vitit 2018 janë gjithsej 40 raste, në vlerën 6,600,000 lekë.

2) Ekzekutimi i detyrueshëm nga Zyrat Përmbarimore të rretheve për gjobat e vendosura për rastet e shkeljes së detyrimeve ligjore si dhe vendimeve gjyqësore që kanë marrë formë të prerë.

Për këtë periudhë të vitit janë ekzekutuar tërësisht gjithsej 126 raste, në vlerën 19,621,561 lekë, nga të cilat 100 raste në vlerën 15,521,561 lekë, kanë kaluar në llogari të të ardhurave të ILDKPKI. Arkëtimi në favor të ILDKPKI i 26 rasteve të tjera, të cilat përbëjnë vlerën 4,200,000 lekë, është në proces likuidimi.

3) Të ardhura të tjera të cilat për periudhën respektive, janë në vlerën 46,560 lekë.

Gjithsej të ardhurat të arkëtuara për 8-mujorin e vitit 2018, janë në vlerën 22,168,121 lekë.

Të gjitha këto të ardhura, të realizuara në zbatim të ligjeve organike mbi të cilat funksionon Inspektorati i Lartë dhe të VKM nr.432 dt.28.06.2006 “Mbi të ardhurat në Institucionet Buxhetore”, kalojnë në Buxhetin e Shtetit në masën 100%.

ILDKPKI, për periudhën në vazhdim në mbështetje të kërkesave në rritje, për përmirësim e mëtejshëm të punës në zbatimin e qëllimeve dhe objektivave të përcaktuara, do të zbatojë me korrektesi të gjitha detyrimet që rrjedhin nga ligji për deklarimin dhe parandalimin e konfliktit të interesave private të zyrtareve, si dhe legjislacionin financiar në fuqi.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM
Kozeta NDOI



Raportet e Monitorimit

Buxheti 2018

Shtojca Nr.7: Raporti i Shpenzimeve Faktike të Programit sipas Artikujve Buxhetorë

ne 000 leke

Institucioni	Inspektorati I Larte I deklarimit dhe Kontrollit te Pasurive dhe Konfliktit te Interesit		Kodi i Grupit 76	
Programi	Planifikim, Menaxhim ,Administrim		Totali I Shpenzimeve	
Artikulli	Emri	Buxheti	Fakti	Diferenca
kodi		Perfundimtar	8-MUJORI	2018
		2018		
600	Paga	102,500.00	67,089.76	35,410.24
601	Sigurime Shoqërore	15,700.00	8,982.69	6,717.31
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	16,760.00	9,147.40	7,612.60
603	Subvencione			-
604	Transferta Korente të Brendshme			-
605	Transferta Korente të Huaja			-
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	389.10	309.10	80.00
Nen-Totali	Shpenzime Korrente	135,349.10	85,528.95	49,820.15
230	Kapitale të Patrupëzuara			-
231	Kapitale të Trupëzuara	3,000.00	1,252.66	1,747.34
Nen -Totali	Shpenzime Kapitale	3,000.00	1,252.66	1,747.34
Totali	Korrente dhe Kapitale	138,349.10	86,781.61	51,567.49
<i>Jashte Buxhetore</i>				
Totali (korrente + kapitale + jashte buxhetore)		138,349.10	86,781.61	51,567.49

Sekretari i	Emri:	Kozeta NDOJ
Pergjithshem	Nenshkrimi	
	Data	18.9.2018



Raportet e Monitorimit

Buxheti 2018

Shtojca Nr.8: Raporti i Shpenzimeve sipas Programeve

ne 000 leke

Inspektorati I Larte I deklarimit dhe Kontrollit te Pasurive dhe Konfliktit te Interesit						
Institucioni						Kodi i Grupit 76
Programi	Planifikim, Menaxhim ,Administrim		Totali I Shpenzimeve 000/leke			
Programi	PBA PLAN 2018	Buxhet Rishikuar 2018	Buxheti Perfundimtar 2018	Fakti 8 - MUJORI 2018	Diferenca 2018	
Titulli	Emri					
01110	Planifikim, Menaxhim ,Administrim	138,200,000.0	138,349,100.0	138,349.1	86,781.6	51,567.5
Totali	Shpenzime të miratuara	138,200,000.00	138,349,100.00	138,349.10	86,781.61	51,567.49

Sekretari i Pergjithshem	Emri:	Kozeta NDOI
	Nenshkrimi	
	Data	18.9.2018



Raportet e Monitorimit

Buxheti 2018

Shtojca Nr.9 Raporti i Realizimit të Rezultateve të Programit

ne 000 leke

Institucioni	Inspektorati I Larte I deklarimit dhe Kontrollit te Pasurive dhe Konfliktit te Interesit				Kodi i Grup	76		
Programi	Planifikim, Menaxhim ,Administrim		Titulli	01110				
Kodi		Njesi	Sasia	Sasia	Realizimi			
Rezultatit	Emri I Rezultatit	Matese	e Planifikuar	Prokuruar gjithsej 8-Mujori 2018	Plotesisht	Pjeserisht	Aspak	Komente
M760024	Blerje Paisje Kompjuterike dhe Elektronike	000/leke	1,200	1,200	1,186,680			perfunduar
M760038	Blerje kondicioner profesional	000/leke	1,500	1,500				Nw proces likujdimi
M760042	Blerje frigorifer për zyrë	000/leke	70	70	70			perfunduar
M760030	Blerje të tjera pajisje zyre	000/leke	230	-				Ne proces prokurimi
	Totali (kapitale)		3,000.0	2,770.0	1,186,750.0			

Sekretari i	Emri:	Kozeta NDOI
Pergjithshem	Nenshkrimi	
	Data:	18.9.2018



Raportet e Monitorimit

Buxheti 2018

Shtojca Nr.10: Raporti I i Shpenzimeve Faktike të Programit sipas Rezultateve

Institucioni		Inspektorati I Larte I deklarimit dhe Kontrollit te Pasurive dhe Konfliktit te Interesit				Kodi i Grupit		76
Programi		Planifikim, Menaxhim ,Administrim		Titulli		01110		
Kodi	Emri I Rezultatit	Shpenzimet e Rezultatit				Kosto per njesi 000/leke		
		PBA Plan 2018	Pl.Buxheti Fillestar 2018	Pl.Buxheti Perfundimtar 2018	Fakti 2018 8-M i prokuruar	Kosto per njesi Plan 2018	Kosto per njesi Fakt 2018	Shpjegime
M760024	Blerje Paisje Kompiuterike dhe Elektronike	1,500.0	1,500.0	1,200	1,200	133.00	131.80	likujduar
M760038	Blerje kondicioner profesional	1,500.0	1,500.0	1,500	1,500	1,500.00	1,380.00	Ne proces likujdimi
M760042	Blerje frigorifer për zyrë			70	70	70.00	65.90	likujduar
M760030	Blerje të tjera pajisje zyre			230				Ne proces prokurimi
Totali (kapitale)		3,000.0	3,000.0	3,000.0	2,770.00			

Sekretari i	Emri:	Kozeta NDOI
Pergjithshem	Nenshkrimi	
	Data:	18.9.2018

